



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inxhinjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Nr. i Prot. Drej. Prot. Prot. No.	539/26
Nr. i Prot. Drej. Prot. Prot. No.	09.09.2026
Nr. i Prot. Drej. Prot. Prot. No.	2
PRISHTINË / A No.1	

Nr. 18-BD/2026
Prishtinë: 08.09.2026

Bordit Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nëparagrafëve 5.13 dhe 5.14 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafëve 1.20 dhe 1.21 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokoll 8648/24; si dhe nenit 13, paragrafëve 1 dhe 2 të Rregullores për Regjistrimin, të Drejtat dhe Detyrimet e Praktikantëve në Fushën e Inxhinierisë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 08.09.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E FORMËS STANDARDE TË VËRTETIMIT PËR PËRFUNDIMIN E PUNËS PRAKTIKE

1. Miratohet forma standarde e Vërtetimit për Përfundimin e Punës Praktike, sipas modelit të bashkëngjitur si Shtojca 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Vërtetimi nga pika 1 e këtij Vendimi lëshohet nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, pas konfirmimit të përfundimit të punës praktike nga inxhinieri mbikëqyrës, në përputhje me nenin 13 të Rregullores për Regjistrimin, të Drejtat dhe Detyrimet e Praktikantëve në Fushën e Inxhinierisë.
3. Vërtetimi për Përfundimin e Punës Praktike nënshkruhet nga Kryetari i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe vuloset me vulën zyrtare të Odës.
4. Administrata e Odës është përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, përgatitjen e vërtetimeve sipas formës standarde të miratuar dhe mbajtjen e evidencës për vërtetimet e lëshuara.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordit Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

*Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Inženjerska komora Republike Kosova
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo*

Në mbështetje të nenit 25, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenit 9, paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për Periudhën e Përkohshme, si dhe nenit 13, paragrafëve 1 dhe 2 të Rregullores për Regjistrimin, të Drejtat dhe Detyrimet e Praktikantëve në Fushën e Inxhinierisë, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës lëshon këtë:

**V È R T E T I M
PËR PËRFUNDIMIN E PUNËS PRAKTIKE**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës vërteton se z. _____, i lindur më _____, me kualifikim akademik _____, drejtimi (specializimi) _____, është regjistruar si anëtar praktikant i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. _____, të datës _____, dhe ka përfunduar punën praktike të regjistruar në Odë në periudhën:

_____ – _____

Puna praktike është zhvilluar nën mbikëqyrjen profesionale të inxhinierit të licencuar _____, me numër të licencës profesionale _____, i cili, përmes konfirmimit të protokolluar në OIRK me nr. _____, të datës _____, ka konfirmuar përfundimin e punës praktike në pajtim me nenin 13, paragrafin 2 të Rregullores për Regjistrimin, të Drejtat dhe Detyrimet e Praktikantëve në Fushën e Inxhinierisë.

Në bazë të këtij konfirmimi dhe dokumentacionit të dorëzuar, konstatohet se praktikanti ka përfunduar periudhën e punës praktike të regjistruar pranë Odës.

Ky vërtetim lëshohet nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, në pajtim me aktet përkatëse të Odës, si dëshmi zyrtare për përfundimin e punës praktike në fushën e inxhinierisë.

Prishtinë, më _____

Kryetari i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
